



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Prot. 1568 Nr

Tiranë, më 31/01 2025

URDHËR

Nr. 148 prot. më 31.01.2025

Mbi zbatimin e procedurave për dhënien e gradave të punonjësve të policisë së burgjeve

*Të gjithë IEVP-ve
Drejtorisë së Policisë së Burgjeve
Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Projekteve
Komisionit, Këtu*

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar, Kreu IV “Gradat në Policinë e Burgjeve”, nenet 36 e në vijim; të Rregullores “Për Personelin e Policisë së Burgjeve”, miratuar me VKM Nr.403, datë 09.06.2022, Kreu IV, nenet 24 dhe në vijim;

Me qëllim, plotësimin e vendeve të lira dhe dhënien e gradave punonjësve të rolit bazë dhe të mesëm të Policisë së Burgjeve,

URDHËROJ:

1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Projekteve, të evidentojë në të gjitha IEVP-të dhe në DPB, numrin e funksioneve të lira për gradat Kryeinspektor; Nen komisar, Komisar dhe Krye komisar.
2. Të gjithë IEVP-të të bëjnë njoftimin për plotësimin e vendeve të lira, në rolin bazë dhe të mesëm të policisë së burgjeve, sipas gradave përkatëse, duke shpallur kriteret përkatëse për çdo gradë dhe vendet e lira, dokumentacionin e parashikuar dhe afatin e aplikimit.¹ Njoftimi të bëhet me datën **01.02.2025**
3. Periudha e aplikimit do të jetë **data 02.02.2025 deri më 14.02.2025**.
4. Drejtoritë e IEVP-ve të bëjnë regjistrimin e punonjësve për konkurrim, bazuar në kërkesat me shkrim, të protokolluara dhe pas verifikimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të punës të dërgojnë në Drejtorinë e Përgjithshme deri më datë **21.02.2025**, me postë. Lista në Excel, të dërgohet edhe me email;
 - Vlerësim pune të punonjësit sipas formatit bashkëlidhur
 - Propozim të drejtorisë së IEVP, të arsyetuar, duke përshkruar plotësimin e kriterëve.
 - Kërkesë individuale të punonjësit që aplikon për gradë
 - Listë përmbledhëse të të gjithë aplikantëve sipas gradave që aplikojnë.

¹ Kriteret sipas nenit 25 të Rregullores së Personelit të Policisë së Burgjeve

5. Drejtoritë e IEVP- ve, përpara se të bëjnë njoftimin e punonjësve të policisë në IEVP për aplikim për ngritje në gradë, të kenë përfunduar gjithë sistemimin e punonjësve me gradat aktuale, sipas pozicioneve që përputhen gradë funksion (neni 38 i Ligjit Nr.80/2020).
6. Drejtoritë e IEVP-ve të bëjnë njoftimin me shkrim të gjithë aplikantëve që nuk plotësojnë kriteret për të aplikuar dhe të trajtojnë të gjitha ankesat, duke njoftuar edhe DPB.
7. Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve verifikon dokumentacionin brenda 20 ditëve nga data e përfundimit të afatit të aplikimit dhe listat e konkurrentëve ja vë në dispozicion Komisionit të Vlerësimit me protokoll.
8. Komisioni i vlerësimit për dhënien e gradave të bëjë testimin me shkrim dhe vlerësimin e konkurrentëve sipas gradave në këto data
 - **Për gradën Kryeinspektor testimi do të zhvillohet datë 10.03.2025-22.03.2025 pranë IEVP.**
 - **Për gradën Nen komisar testimi do të zhvillohet datë 11.03.2025 në DPB**
 - **Për gradën Komisar testimi do të zhvillohet datë 12.03.2025 në DPB**
 - **Për gradën Krye komisar testimi do të zhvillohet datë 13.03.2025 në DPB**
9. Komisioni vlerësimit për dhënien e gradave të bëjë vlerësimin e konkurrenteve, sipas nenit 32 të Rregullores së Personelit të Policisë së Burgjeve sipas gradave nga data 10 ditë pas vlerësimit të testit me shkrim për secilën gradë.
10. Qendra e Trajnimit të organizojë trajnimin e kandidatëve të shpallur fitues brenda një muaj nga përfundimi i procesit të vlerësimit.
11. Drejtori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Projekteve të bëjë propozimet për plotësimin e vendeve të lira dhe dhënien e gradave tek autoritetet **pas përfundimit të procesit të vlerësimit**
Ndjek zbatimin e këtij Urdhri, Drejtori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Projekteve
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.
12. Numri i funksioneve të lira për secilën gradë është si më poshtë:

Tabela përmbledhëse e vendeve vakante për secilën gradë

Nr.	INSTITUCIONI	Oficer			Polic
		K/Komisar	Komisar	N/Komisar	K/Isnpektor
1	D. P. Burgjeve	8	0	9	12
2	IEVP në Rrugën "Ali Demi"	1	3	0	10
3	IEVP, Paraburgim Berat	1	2	1	8
4	IEVP Burrel	0	2	3	15
5	IEVP Durrës	0	2	0	15
6	IEVP Elbasan	1	2	+1	14
7	IEVP Fier	1	3	+1	19

8	IEVP Fushe Krujë	1	2	0	21
9	IEVP, Paraburgim 313 "Jordan Misja"	1	1	0	16
10	IEVP Kavaje	0	2	0	6
11	IEVP Korçë	1	3	1	17
12	IEVP, Paraburgim Kukës	0	1	0	0
13	IEVP Lezhe	0	0	0	0
14	IEVP Lushnje	1	1	2	15
15	IEVP, Paraburgim 302 "Mine Peza"	0	0	1	13
16	IEVP Peqin	2	2	0	29
17	IEVP Rrogozhine	1	5	1	10
18	Qendra Spitalore e Burgjeve	0	0	0	14
19	IEVP Shkoder	1	6	.+4	21
20	IEVP Tepelene	0	2	.+1	13
21	IEVP Pajiske	1	6	0	15
22	IEVP Vlore	0	4	0	14
TOTALI		21	49	18	297

13. Kriteret për fitimin e gradës²:

Punonjësi i Policisë së Burgjeve, për fitimin e gradës së radhës, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtëme:

- a. *Të ketë vlerësim vjetor pozitiv të punës gjatë kohës së qëndrimit në gradë;*
- b. *Të përmbushë kriteret për pozicionin e punës, sipas fushës së shërbimit;*
- c. *Të mos ketë masë disiplinore në fuqi për shtyrjen e afatit të ngritjes në gradë, sipas parashikimeve në legjislacionin për Policinë e Burgjeve;*
- d. *Të ketë përfunduar me sukses trajnimin profesional për marrjen e gradës së radhës;*
- e. *Të ketë plotësuar kohën e qëndrimit në gradë, sipas afateve të mëposhtëme;*
 - *Nga Inspektor në Kryeinspektor 5 vjet*
 - *Nga Kryeinspektor në Nënkomisar 5 vjet*
 - *Nga Nënkomisar në Komisar 3 vjet*
 - *Nga Komisar në Kryekomisar 4 vjet*

14. Testimi për ngritje në gradë³:

² Neni 25 i Rregullosës së Personelit të Policisë së Burgjeve, miratuar me VKM Nr.403, datë 09.06.2022

³ Neni 31 dhe 32 i Rregullosës së Personelit të Policisë së Burgjeve, miratuar me VKM Nr.403, datë 09.06.2022

- Për ngritje nga grada Inspektor në Kryekomisar, faza e parë e përzgjedhjes është provimi me shkrim, për të testuar njohuritë teknike të kandidatit në fushën e legjislacionit në fuqi për Policinë e Burgjeve, të legjislacionit penal, të legjislacionit bazë administrative dhe aftësive bazë të drejtimit.
- Kufiri minimal për kalimin me sukses të testimit përkatës nuk mund të jetë më i ulët se 70% e vlerës së përgjithshme të pikëve të testimit.
- Rezultatet e testimit me shkrim përbëjnë 50% të rezultatit të përgjithshëm të vlerësimit të kandidatit për fitimin e gradës së radhës.
- Pas testimit me shkrim, kandidatët vlerësohen për:
 - a. Aftësitë komunikuese
 - b. Aftësitë menaxhuese dhe drejtuese
 - c. Aftësitë vendimmarrëse
 - d. Aftësitë gjyqesore
 - e. Motivimi personal
 - f. Legjislacioni dhe instrumentet ndërkombëtare të sistemit të burgjeve
- Kufiri minimal për kalimin me sukses të vlerësimit nuk mund të jetë më i ulët se 70%.
Rezultatet e testimit profesional janë 50% e vlerësimit të përgjithshëm.

15. Përgjigjet për zbatimin e këtij Urdhëri, Komisioni i Vlerësimit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve, dhe Projekteve.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

KLEVIS QOSE

